



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.199/11 prot.

Datë 16.02.2024

V E N D I M
Nr.184/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 165/2024, datë 09.02.2024, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt “*Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet*”, me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERJISË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.

Ankimues: Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK,
me NIPT: L81506043D, dhe Adresë: Rr. “Idriz Dollaku”, Apartamenti 2, shk, 1, kati i I, L. Ali Demi, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: BURSA SHQIPTARE E ENERJISË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.
Adresa: Rr. “Liman Kaba”, Rezidenca Olympic, Shkalla 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 165/2024, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "INSTANT.AL" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt "Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet", me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.*
- 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "INSTANT.AL" SHPK, për modifikim të dokumenteve të procedurës së prokurimit sipër cituar.*
- 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "INSTANT.AL" SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 45/10 prot., datë 15.02.2024, protokolluar me tonën nr. 199/8 prot., datë 16.02.2024, me objekt "Zbatim Vendimi" autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 165/2024, datë 09.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën ardhur me nr. 45/10 prot., datë 15.02.2024, protokolluar me tonën nr. 199/8 prot., datë 16.02.2024, me objekt "Zbatim Vendimi" autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 165/2024, datë 09.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt "Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet", me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, AK ka bashkëlidhur shkresën me Nr.45/9 Prot., datë 15.02.2024 dhe objekt “Njoftim për ndryshimin e dokumentave të tenderit” me të cilën ka modifikuar kriteret e veçanta për kualifikim duke hequr kriteret 2.3.4 dhe 2.3.5 si edhe ka vendosur shtyrjen e afatit të pranimit të ofertave.

Komisioni nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohej se, autoriteti kontraktor ka publikuar dokumentin sipërcituar për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin Nr. 165/2024, datë 09.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor BURSA SHQIPTARE E ENERGIJË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX, ka zbatuar vendimin Nr. 165/2024, datë 09.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt “Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet”, me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERGIJË ELEKTRIKE SH.A – ALPEX.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

